



Biografi e shkurtër

Z. Denis Roka, u diplomua me rezultate shumë të mira në vitin 2006 në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Në vitin 2010 përfundoi Masterin e Nivelit të Dytë në Administrim Publik (MPA) në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

Në qershor të vitit 2007 filloi punë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ku punoi në disa sektorë, duke ushtruar detyrën e Specialistit, Përgjegjësit dhe Drejtorit, deri në dhjetor të vitit 2014. Ka qenë pjesë e Grupeve të Punës për reformën në legjislacionin e shoqërive tregtare, si dhe hartimin e disa ligjeve në këtë fushë, si Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligji “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”, Ligji “Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike”, Ligji “Për tregtinë elektronike”, Ligji “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, etj.

Nga viti 2010 – 2013 ka qenë pedagog i jashtëm në Universitetin Justiniani I në lëndën “E Drejtë Tregtare” dhe “E Drejtë Ndërkombëtare Private”.

Në vitin 2008 ka fituar titullin “Avokat”, profesion të cilin e ka ushtruar në mënyrë aktive nga shkurti 2016 deri në janar 2018. Zotëron gjithashtu licencën e Ndërmjetësit Ligjor.

Ka botuar Librin “Sisteme Politike te Qeverisjes” –Volumi I, Shtëpia Botuese “DUDAJ”, me ISBN 978-99943-0-306-9.

Zotëron gjuhën angleze, italiane dhe turke. Gëzon njohuri të gjuhës frënge dhe gjermane.